



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*  
*Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport*

*Departamenti i Sportit / Department Za Sport / Sports Department*



---

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 03 / 2015**  
**PËR**  
**THEMELIMIN DHE REGJISTRIMIN E KLUBEVE PUBLIKE DHE PRIVATE TË SPORTIT**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 03 / 2015**  
**ON**  
**ESTABLISHMENT AND REGISTRATION OF PUBLIC AND PRIVATE SPORTS CLUBS**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 03 / 2015**  
**ZA**  
**OSNIVANJE I REGISTRACIJU JAVNIH I PRIVATNIH SPORTSKIH KLUBOVA**



<b>Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit</b>	<b>Minister of Culture, Youth and Sports</b>	<b>Ministar Kulture, Omladine i Sporta</b>
<p>Në mbështetje të Nenit 32 të Ligjit Nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/24 për Sport (Gazeta Zyrtare Nr. 02/2012, me datë 20 janar 2012), nenit 8 nënparagrafi 1.4 i Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, me datë 12.09.2011),</p>	<p>Pursuant to Article 32 of Law no. 04/L-075 on Amending and Supplementing the Law No. 2003/24 on Sports (Official Gazette No. 02/2012, on 20 January 2012), Article 8 sub-paragraph 1.4 of the Regulation No. 02/2011 on the scope of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, and based on Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011 (Official Gazette No. 15, on 12. 09. 2011),</p>	<p>U skladu sa članom 32 zakona br. 04/L-075 o izmeni i dopuni zakona br. 2003/24 za sport (službeni glasnik br. 02/2012, datuma 20 januar 2012); na osnovu člana 8, tačka 1.4 uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativnih odgovornosti kancelarije premijera i ministarstava, kao i na osnovu člana 38, stav 6 uredbe o radu vlade br. 09/2011 (službeni glasnik br. 15, datuma 12.09.2011),</p>
<p>Nxjerr,</p>	<p>Issues,</p>	<p>Izdaje,</p>
<p><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2015 PËR THEMELIMIN DHE REGJISTRIMIN E KLUBEVE PUBLIKE DHE PRIVATE TË SPORTIT</b></p>	<p><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION No. 03/2015 ON ESTABLISHMENT AND REGISTRATION OF PUBLIC AND PRIVATE SPORTS CLUBS</b></p>	<p><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 03/2015 ZA OSNIVANJE I REGISTROVANJE JAVNIH I PRIVATNIH SPORTSKIH KLUBOVA</b></p>
<p><b>KLUBET PUBLIKE TË SPORTIT</b></p>	<p><b>PUBLIC SPORTS CLUBS</b></p>	<p><b>JAVNI SPORTSKI KLUBOVI</b></p>
<p><b>Neni 1</b></p>	<p><b>Article 1</b></p>	<p><b>Član 1</b></p>
<p>1. Klube publike të sportit janë të gjitha organizatat sportive të cilat janë të themeluara nga së paku pesëmbëdhjetë (15) persona fizik të moshës madhore (mbi 18 vj.) në cilësinë udhëheqëse dhe organizative të punës, ose nga së paku një person juridik.</p>	<p>1. Public sport clubs are all sport organizations which are established by at least fifteen (15) natural persons of age (over 18 yrs.) in leadership and organizational capacity for work, or at least one legal person.</p>	<p>1. Javni sportski klubovi su sve sportske organizacije koje su osnovane od najmanje petnaest (15) fizičkih lica odrasle starosti (više od 18 godina), u rukovodećem i organizativnom smislu rada, ili od najmanje jednog pravnog lica.</p>



<p>2. Klubet nuk mund të emërtohen ose të mbajnë emrin e Shtetit "Kosova", (përfshirë emërtimet tjera në gjuhët e komuniteteve të Kosovës) dhe të shteteve tjera.</p> <p>2.1. Monitorimin e zbatimit të kësaj dispozite e bëjnë drejtoritë komunale për sport dhe Federatat e Sportit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b></p> <p>1. Klubet publike të sportit kanë statusin e organizatave jo-qeveritare (OJQ). Ato regjistrohen në Departamentin përkatës të OJQ-ve dhe në Drejtorinë Komunale për sport.</p> <p>2. Të gjitha klubet obligohen të ofrojnë të dhënat statistikore për çdo vit tek organet shtetërore, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Departamenti i Sportit, drejtoritë komunale për sport, etj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b></p> <p>1. Pasurinë e klubeve publike e përbëjnë:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. pasuria në të holla;</p>	<p>2. Clubs can not be named or carry the name of the State "Kosovo", (including other names in the languages of communities in Kosovo) and of other countries.</p> <p>2.1. Monitoring the implementation of this provision is conducted by Municipal Departments of Sports and Sports Federations.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b></p> <p>1. Public sports clubs have the status of non-governmental organizations (NGOs). They are registered in the corresponding Department of NGOs and Municipal Directorate of Sports.</p> <p>2. All clubs are required to provide statistical data annually to state authorities, Kosovo Statistics Agency, Department of Sports, Municipal Departments of Sports, etc.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3</b></p> <p>1. Property of public clubs comprise of:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. property into cash;</p>	<p>2. Klubovi se ne mogu imenovati ili držati ime države "Kosovo" (uključujući i ostale nazive na jezicima ostalih zajednica koje žive na Kosovu) i drugih država.</p> <p>2.1. Nadgledanje sprovođenja ove odredbe vrše opštinska odeljenja za sport i federacije sporta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b></p> <p>1. Javni sportski klubovi imaju status nevladine organizacije (NVO). Iste se registruju u odgovarajućem odeljenju NVO-a i pri opštinskim odeljenjima za sport.</p> <p>2. Svi klubovi su obavezni da pružaju statistike podatke državnim organima za svaku godinu, Kosovskoj agenciji za statistike, odeljenju sporta, opštinskim odeljenjima za sport, itd.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3</b></p> <p>1. Imovina javnih sportskih klubova se sastoji od:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. imovine u novcu;</p>
--	--	---



<p>1.2. pronësia në gjërat e paluajtshme;</p> <p>1.3. pronësia në gjërat e luajtshme;</p> <p>1.4. të drejtat tjera pronësore dhe jopronësore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b></p> <p>Klubi publik i sportit nuk ka të drejtë të merret me veprimtari, në të cilat do të realizohet fitim për themeluesit, anëtarët apo personat e tretë. Mirëpo, fitimi eventual duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e qëllimeve sportive për të cilat klubi është themeluar.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b></p> <p>Klubet publike të sportit, kanë të drejtë të lidhin kontrata pune me lojtarët, trajnerët dhe me stafin tjetër administrativ dhe profesional të klubit, në bazë të ligjit të punës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p> <p>1. Organet e domosdoshme të klubit publik të sportit janë:</p>	<p>1.2. the property in immovable items;</p> <p>1.3. the property in movable items;</p> <p>1.4. other property and non-property rights.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b></p> <p>Public sports club is not entitled to engage in activities which generate revenues for the founders, members or third parties. But eventual profit must be used for delivering the sports goals for which the club has been established.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 5</b></p> <p>Public sport clubs have the right to conclude employment contracts with players, coaches and other administrative and professional staff of the club, according to labor law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p> <p>1. Necessary bodies of public sports club are as follows:</p>	<p>1.2. vlasništvo nepokretne imovine;</p> <p>1.3. vlasništvo pokretne imovine;</p> <p>1.4. ostala imovinska i neimovinska prava.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b></p> <p>Javni sportski klub nema pravo da se bavi delatnošću gde se realizuje zarada za osnivača, ili treću osobu. Međutim, eventualna zarada se treba upotrebiti za razvijanje sportskih ciljeva za koje je i slub osnovan.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 5</b></p> <p>Javni sportski klubovi imaju pravo da sklope radne ugovore sa igračima, trenerima i ostalim administrativnim i profesionalnim osobljem kluba, na osnovu zakona za rad.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b></p> <p>1. Neophodna tela javnog sportskog kluba su:</p>
---	---	--



<p>1.1. Kuvendi;</p> <p>1.2. Bordi;</p> <p>1.3. Kryetari;</p> <p>1.4. Sekretari, dhe</p> <p>1.5. Këshilli Mbikëqyrës.</p>	<p>1.1. Assembly;</p> <p>1.2. Board;</p> <p>1.3. President;</p> <p>1.4. Secretary, and</p> <p>1.5. Supervisory Board.</p>	<p>1.1. Skupština;</p> <p>1.2. Bord;</p> <p>1.3. Predsedavajući;</p> <p>1.4. Sekretar; i</p> <p>1.5. Nadzorni odbor.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b></p>
<p>1. Aktet normative themelore të cilat duhet t'i ketë klubi publik i sportit janë:</p> <p>1.1. Certifikata e OJQ-së;</p> <p>1.2. Statuti;</p> <p>1.3. Rregullorja e punës së Kuvendit;</p> <p>1.4. Rregullorja e punës së Bordit, dhe</p> <p>1.5. Rregullorja e punës së Këshillit Mbikëqyrës.</p> <p>2. Dëshmia që klubi ka siguruar kushtet e nevojshme për funksionim normal (selia, kuadri profesional i kualifikuar, hapësira</p>	<p>1. Basic normative acts which the public sports club must have, are as follows:</p> <p>1.1. NGO certificate;</p> <p>1.2. Statute;</p> <p>1.3. Rules of Procedure of the Assembly.</p> <p>1.4. Rules of Procedure of the Board, and</p> <p>1.5. Rules of Procedure of the Supervising Council.</p> <p>2. Evidence that the club has provided the conditions necessary for normal functioning (main office, qualified</p>	<p>1. Osnovni normativni akti koje javni sportski klub treba posedovati su:</p> <p>1.1. Uverenje NVO-a;</p> <p>1.2. Statut;</p> <p>1.3. Uredba o radu skupštine;</p> <p>1.4. Uredba o radu borda; i</p> <p>1.5. Uredba o radu nadzornog odbora.</p> <p>2. Dokaz da je klub obezbedio uslove neophodne za normalno funkcionisanje (sedište, profesionalni i kvalifikovani</p>



<p>dhe pajisjet për zhvillimin e aktiviteteve sportive).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>1. Klubet janë të obliguara që në bazë vjetore të dorëzojnë raportet financiare në drejtorinë komunale për sport, të cilat duhet të jenë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i klubit ose auditori i jashtëm.</p> <p>2. Klubet publike janë të obliguara, që për të gjitha ndryshimet e bëra në aktet normative dhe në strukturën udhëheqëse, ta njoftojnë me shkrim Drejtorinë komunale për sport (pranë Komunës ku klubi e ka selinë), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej datës kur është marrë vendimi.</p> <p>3. Klubet publike e kanë për obligim që të njoftojnë me shkrim Drejtorinë për Sport të komunës përkatëse, për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes të kuvendit themelues dhe mbledhjeve tjera të kuvendit, së paku 7 ditë përpara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b></p> <p>1. Klubit publik, për regjistrim në Drejtorinë e Sportit të Komunës përkatëse i nevojiten:</p>	<p>professional staff, space and equipment for development of sports activities).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>1. Clubs are required to annually submit financial reports to the municipal sports directorates, which must be approved by the Supervisory Council of the club or external auditor.</p> <p>2. Public clubs are obliged for all changes made to the normative acts and in governing structure, to notify in written the Municipal Directorate of Sports (at the Municipality where the club has its main office), within fifteen (15) days from the date the decision was made.</p> <p>3. Public clubs are obliged to notify in written the Municipal Directorate of Sports for the time and place of the meeting of the founding assembly and other meetings of the assembly, at least 7 days in advance.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b></p> <p>1. Public club, for registration in the Department of Sports of the respective municipality needs as follows:</p>	<p>kadar, prostorije i uređaje za razvoj sportskih aktivnosti).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>1. Klubovi su obavezni da na godišnjoj osnovi podnose finansijske izveštaje opštinskim odeljenjima za sport, koji trebaju biti usvojeni od strane nadzornog odbora kluba ili spoljašnjeg revizora.</p> <p>2. Javni klubovi su obavezni da o izmenama načinjenim u normativnim aktima i rukovodećoj strukturi, napismeno obaveste opštinsko odeljenje za sport (pri opštini gde klub ima svoje sedište), u roku od petnaest (15) dana, od datuma donošenja odluke.</p> <p>3. Obaveza je javnih klubova da napisemeno obaveste odeljenje za sport odgovarajuće opštine o vremenu i mestu održavanja osnivačke skupštine i ostalih sastanaka skupštine, i to najmanje 7 dana unapred.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b></p> <p>1. Javnom klubu za registraciju pri odeljenju za sport odgovarajuće opštine trebaju:</p>
---	---	---



<p>1.1. aktet normative nga neni 7 i këtij Udhëzimi;</p> <p>1.2. nënshkrimet e themeluesve të klubit, numrat dhe kopjet e letërnjoftimeve;</p> <p>1.3. procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Themelues;</p> <p>1.4. vendimi për zgjedhjen e Bordit Drejtues, Kryetarit dhe Këshillit Mbikëqyrës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b></p> <p>Drejtoritë Komunale për sport obligohen të mbajnë regjistrat për klubet sportive të regjistruara në Komunat e tyre.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b></p> <p>1. Nëse Drejtoria Komunale për Sport nuk e regjistron klubin sportiv publik, parashtruesi i kërkesës për regjistrim ka të drejtën e ankesës në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e marrjes së vendimit.</p> <p>2. Ankesa i parashtrohet Departamentit për Sport në Ministrinë përkatëse për Sport, vendimi i të cilit është definitiv.</p>	<p>1.1. normative acts from Article 7 of this Instruction;</p> <p>1.2. signatures of the founders of the club, ID numbers and copies;</p> <p>1.3. minutes from the meeting of Founding Assembly;</p> <p>1.4. decision for appointment of the Board of Directors, Chairman of the Supervisory Board.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b></p> <p>Municipal Departments of Sports are obliged to keep records for sports clubs registered in their municipalities.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b></p> <p>1. If the Municipal Directorate of Sport does not register a public sports club, the applicant for registration has the right to appeal within fifteen (15) days from the date of the decision.</p> <p>2. The appeal is submitted to Sports Department in the respective Ministry of Sports, decision of which will be final.</p>	<p>1.1. normativni akti iz člana 7 ovog uputstva;</p> <p>1.2. potpisi osnivača kluba, brojevi i kopije ličnih karata;</p> <p>1.3. zapisnik sa sastanka osnivačke skupštine;</p> <p>1.4. odluka za selekciju upravnog odbora, predsedavajućeg i nadzornog odbora.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b></p> <p>Opštinska odeljenja za sport su dužna da vode registre za sportske klubove registrovane u svojim opštinama.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b></p> <p>1. Ako opštinsko odeljenje za sport registruje javni sportski klub, podnosilac zahteva za registraciju ima pravo žalbe u roku od petnaest (15) dana, od datuma donošenja odluke.</p> <p>2. Žalba se podnosi odeljenju za sport pri odgovarajućem ministarstvu za sport, odluka kojeg je definitivna.</p>
---	--	---



Neni 12	Article 12	Član 12
<p>1. Klubi publik mund të shndërrohet në klub privat, sipas dispozitave të parapara në këtë nen.</p> <p>2. Vendimin për ndërprerjen e aktivitetit si OJQ me qëllim të themelimit të klubit sportiv privat e miraton Kuvendi i klubit me 2/3 e votave të anëtarëve prezent, numri i të cilëve nuk lejohet të jetë më i vogël se 2/3 e numrit të përgjithshëm të kuvendarëve të klubit.</p> <p>3. Vendimi duhet të merret në harmoni me dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ dhe me ligjet përkatëse për regjistrim të biznesit.</p> <p>4. Vendimit të Kuvendit të klubit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet vijuese:</p> <p>4.1. akti normativ që rregullon të drejtat dhe obligimet e sportistëve dhe anëtarëve të klubit;</p> <p>4.2. raporti për auditimin e aktivitetit të klubit, i kryer nga institucioni i autorizuar;</p> <p>4.3. raporti i vlerësimit të vlerës dhe</p>	<p>1. Public club can be turned into a private club, according to the provisions in this article.</p> <p>2. Decision to terminate the activity as an NGO with the aim of establishing private sports club is approved by Assembly of the club by 2/3 of votes of the members present, number of which is not allowed to be smaller than 2/3 of the total number of club assembly members.</p> <p>3. Decision must be taken in harmony with the provisions of the Law on Freedom to Associate in an NGO and with the respective laws for business registration.</p> <p>4. The following documents need to be attached to Decision of the Assembly of the club:</p> <p>4.1. normative act regulating rights and obligations of athletes and members of the club;</p> <p>4.2. report for auditing club activity, carried out by an authorized institution;</p> <p>4.3. report of evaluating the value of</p>	<p>1. Javni klub se može pretvoriti u privatni klub, na osnovu odredbi predviđenih ovim članom.</p> <p>2. Odluku o prekidu aktivnosti kao NVO, sa ciljem uspostavljanja privatnog sportskog kluba, Vusvaja skupština kluba sa 2/3 glasova prisutnih članova, broj kojih ne sme biti manji od 2/3 opšteg broja članova kluba.</p> <p>3. Odluka se moa doneti u skladu za odredbama zakona za slobodu udruživanja u NVO i odgovarajućim zakonima za registrovanje poslovanja.</p> <p>4. Odluci skupštine kluba treba priložiti sledeće dokumente:</p> <p>4.1. normativni akt koji reguliše prava i obaveze sportista i članova kluba;</p> <p>4.2. izveštaj o reviziji aktivnosti kluba, koju vrši ovlašćena institucija;</p> <p>4.3. izveštaj o proceni vrednosti</p>





<p>pasurisë së klubit, i kryer nga institucioni i autorizuar;</p> <p>4.4. dëshmitë mbi të drejtën e pronësisë, ose të drejtën e shfrytëzimit të objekteve sportive ose patundshmërive të tjera;</p> <p>4.5. pasqyrën e të gjithë personave fizik dhe juridik të lajmëruar si të interesuar për të themeluar klubin sportiv privat si biznes.</p> <p>5. Pas regjistrimit si klub privat, vlejné dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.</p> <p>6. Klubi privat regjistrohet në regjistrin shtetëror përkatës të bizneseve dhe shoqërive tregtare.</p> <p>7. Për ndërrimin e statusit juridik të klubit, menjëherë duhet të informohen me shkrim: Departamenti i OJQ-ve, Drejtoria për Sport e Komunës përkatëse dhe Federata e sportit përkatës.</p> <p>8. Klubi obligohet që në regjistrin shtetëror përkatës të bizneseve dhe shoqërive tregtare, dhe në federatën përkatëse të sportit të paraqesë listën e plotë të aksionarëve / pronarëve dhe përqindjen e</p>	<p>property of the club, carried out by an authorized institution;</p> <p>4.4. evidence on the property right or right of use of sports facilities or other real estate;</p> <p>4.5. statement of all natural and legal persons heralded as interested to establish private sports club as business.</p> <p>5. Following registration as a private club, the provisions of the Law on Business Companies.</p> <p>6. Private club is registered in the respective state registry of businesses and trade companies.</p> <p>7. For amendment of the legal status of the club, the following must be informed in written immediately: Department of NGOs, Directorate of Sports of the respective municipality and the respective sports Federation.</p> <p>8. The club is obliged to register in the respective state businesses and companies registry, and in the respective sports Federation to submit a complete list of shareholders / owners and their percentage</p>	<p>imovine kluba, koju vrši ovlašćena institucija;</p> <p>4.4. dokaze o imovinskim pravima, ili pravo na korišćenje sportskih objekata i ostalih nekretnina;</p> <p>4.5. izveštaj o svim fizičkim ili pravnim Licim prijavljenih kao zainteresovanih za osnivanje privatnog sportskog kluba kao poslovanje.</p> <p>5. Nakon registracije kao privatni klub, važe odredbe zakona za trgovačka društva.</p> <p>6. Privatni klub se registruje u odgovarajućem državnom registru polsovanja i trgovačkih društva.</p> <p>7. Za izmenu pravnog statusa kluba, odmah se napismeno treba obavestiti: odeljenje NVO-a, opštinsko odeljenje za sport odgovarajuće opštine i odgovarajuća sportska federacija.</p> <p>8. Klub je dužan da u odgovarajućem državnom registru poslovanja i trgovačkih društva, i odgovarajućoj sportskoj federaciji, dostavi potpunu listu akcionara/vlasnika i njihov</p>
---	--	---



<p>tyre të aksioneve.</p> <p>9. Klubi, gjegjësisht shoqëria tregtare, që shndërrohet nga klubi publik në klub privat merr mbi vete të gjitha obligimet juridike dhe financiare të klubit publik.</p> <p>10. Federata sportive ia njeh klubit sportiv të regjistruar si shoqëri tregtare vazhdimësinë e rezultateve (plasmani në tabelë, rang dhe statusi në sistemin e garave) të arritur në garat e federatës përkatëse, pavarësisht nëse e ndryshon emrin apo jo.</p> <p>11. Objektet, inventari dhe pajisjet sportive që janë pronë e shtetit, komunave ose pronë publike nuk lejohet të përfshihen në regjistrin e pronës së klubit, kur bëhet regjistrimi i pronës së klubit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b></p> <p>1.1 njëjti person fizik apo juridik nuk mund të jetë i angazhuar në strukturat qeverisëse të dy klubeve të sportit të njëjtë.</p> <p>2. Përjashtim nga ky rregull kemi atëherë kur një person fizik apo juridik angazhohet</p>	<p>in shares.</p> <p>9. Club, respectively trade company which converts from a public club into a private club, takes over all legal and financial obligations of the public club.</p> <p>10. Sports Federation recognizes the registered sports club as a business, continuity results (placement on the table, rank and status in the system of competition) reached in the relevant federal competitions, regardless of whether or not changes its name.</p> <p>11. Facilities, inventory and sports equipment which are state, municipal or public property are not allowed to be included in the register of the club property, when club property registration is carried out.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b></p> <p>1. The same natural or legal person may be involved in the governance structures of the two clubs of the same sport.</p> <p>2. There is exception from this rule when a natural or legal person is engaged in two</p>	<p>procenat akcija.</p> <p>9. Klub, tačnije trgovačko društvo, koje se iz javnog kluba pretvori u privatni klub, preuzima sve pravne i finansijske obaveze privatnog kluba.</p> <p>10. Sportska federacija sportskom klubu registrovanog kao trgovačko društvo, priznaje kontinuitet rezultata (plasman na tabli, rang i status u sistemu takmičenja) postignutih tokom takmičenja odgovarajuće federacije, bez obzira da li ista menja svoje ime ili ne.</p> <p>11. Objekti, inventar i uređaji koji su Vlasništvo države, opštine ili javne imovine, ne smeju se obuhvatiti u registru imovine kluba kada se vrši registracija o imovini kluba.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b></p> <p>1. Isto fizičko ili pravno lice ne može biti angažovano u rukovodećim strukturama dva ista sportska kluba.</p> <p>2. Izuzetak od ovog pravila jeste kada jedno fizičko ili pravno lice ima u dva</p>
--	--	---



<p>në dy klube sportive të gjinive të ndryshme (klube të meshkujve dhe të femrave).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p>Sistemin e kriterëve të licencimit të të gjitha klubeve, pa marrë parasysh statusin juridik të tyre e përcaktojnë Federatat përkatëse të sportit.</p> <p style="text-align: center;"><b>PUSHIMI I PUNËS SË KLUBIT PUBLIK TË SPORTIT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b></p> <p>1. Klubi Publik i sportit pushon të ekzistojë:</p> <p>1.1. Me vendimin e anëtarëve të kuvendit, me 2/3 e votave;</p> <p>1.2. Në qoftëse numri i anëtarëve mbetet më i vogël se numri i anëtarëve të nevojshëm sipas kriterëve për themelimin e Klubit sportiv;</p> <p>1.3. Në qoftëse nuk merret me aktivitetet për të cilat është themeluar</p>	<p>sports clubs of different genders (male and female clubs).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b></p> <p>System of licensing criteria of all clubs, regardless of their legal status is determined by respective sports Federation.</p> <p style="text-align: center;"><b>TERMINATION OF WORK OF THE PUBLIC SPORTS CLUB</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b></p> <p>1. Public sports club ceases to exist:</p> <p>1.1. Upon decision of the assembly members, with 2/3 of the votes;</p> <p>1.2. If the number of members remains lower than the number of required number according to criteria for establishment of the Sports Club;</p> <p>1.3. If it does not deal with the activities for which it was established in duration</p>	<p>kluba različitog pola (muški i ženski klub).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b></p> <p>Sistem kriterijuma za licencovanje svih klubova, bez obzira na njihov pravni status, određuje odgovarajuća federacija sporta.</p> <p style="text-align: center;"><b>PRESTANAK RADA JAVNOG SPORTSKOG KLUBA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b></p> <p>1. Javni sportski klub prestaje da postoji:</p> <p>1.1. Odlukom članova skupštine, sa 2/3 glasova;</p> <p>1.2. Ako broj članova ostanje manji od broja članova neophodnih na osnovu kriterijuma za osnivanje sportskog kluba;</p> <p>1.3. Ako se aktivno ne bavi aktivnosti za koje je i osnovan u periodu više od</p>
--	--	--



<p>në kohëzgjatje për më shumë se një vit; 1.4. Në rastet tjera të parashikuara me Ligjin për Sportin.</p> <p><b>KLUBET PRIVATE TË SPORTIT</b></p> <p><b>Neni 16</b></p> <p>1. Klubin sportiv privat mund ta themelojnë personat fizik dhe juridik, vendorë dhe të huaj.</p> <p>2. I njëjti person fizik dhe juridik nuk mund të jetë themelues apo bashkëthemelues i më shumë se një klubi të njëjtit sport.</p> <p><b>Neni 17</b></p> <p>1. I njëjti person fizik apo juridik nuk mund të ketë asnjë përqindje të aksioneve në më shumë se një klub të sportit të njëjtë.</p> <p>2. Përcjashtim nga ky rregull kemi atëherë kur një person fizik apo juridik ka aksione në dy klube të gjinive të ndryshme (klube të meshkujve dhe të femrave).</p>	<p>for more than a year; 1.4. In other cases stipulated by Law on Sports.</p> <p><b>PRIVATE SPORTS CLUBS</b></p> <p><b>Article 16</b></p> <p>1. Private sports club can be established by natural and legal persons, local and foreign.</p> <p>2. The same natural or legal person may not be the founder or co-founder of more than a club of the same sport.</p> <p><b>Article 17</b></p> <p>1. The same natural or legal person may not have any percentage of shares in more than a club of the same sport.</p> <p>2. There is exception from this rule when a natural or legal person has shares in two sports clubs of different genders (male and female clubs).</p>	<p>godinu dana; 1.4. U ostalim slučajevima predviđenim zakonom za sport.</p> <p><b>PRIVATNI SPORTSKI KLUBOVI</b></p> <p><b>Član 16</b></p> <p>1. Privatni sportski klub mogu osnovati fizička i pravna lica, domani ljudi ili s tranci.</p> <p>2. Isto fizičko i prano lice ne može biti osnivač iliko-osnivač više od jednog sportskog kluba istog sporta.</p> <p><b>Član 17</b></p> <p>1. Isto fiziko ili prano lice ne može imati nikakav procenat akcija u više od jednog istog sportskog kluba.</p> <p>2. Izuzetak od ovog pravila jeste kada jedno fizičko ili pravno lice ima u dva kluba različitog pola (muški i ženski klub).</p>
---	---	---



<b>Neni 18</b>	<b>Article 18</b>	<b>Član 18</b>
<p>1. Aktet normative themelore të cilat duhet t'i ketë klubi privat i sportit janë:</p> <p>1.1. Statuti;</p> <p>1.2. Rregullorja e punës së Bordit;</p> <p>1.3. Rregullorja e punës së Këshillit Mbikëqyrës.</p> <p>1.4. Dëshmia që klubi ka siguruar kushtet e nevojshme për funksionim normal (selia, kuadri profesional i kualifikuar, hapësira dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive).</p>	<p>1. Basic normative acts which the private sports club must have, are as follows:</p> <p>1.1. Statute;</p> <p>1.2. Rules of Procedure of the Board.</p> <p>1.3. Rules of Procedure of the Supervising Council.</p> <p>1.4. Evidence that the club has provided the conditions necessary for normal functioning (main office, qualified professional staff, required space and equipment for development of sports activities).</p>	<p>1. Osnovni normativni akti koje privatni sportski klub treba imati su:</p> <p>1.1. Statut;</p> <p>1.2. Uredba o radu borda;</p> <p>1.3. Uredba o radu nadzornog odbora;</p> <p>1.4. Dokaz da je klub osigurao uslove neophodne za normalno funkcionisanje (sedište, profesionalno kvalifikovani kadar, prostorije i neophodne uređaje za razvijanje sportskih aktivnosti).</p>
<b>Neni 19</b>	<b>Article 19</b>	<b>Član 19</b>
<p>Pronarë apo aksionarë në klubet private nuk mund të jenë pronarët e bastoreve sportive.</p>	<p>Owners of sports betting shops <b>can not</b> be owners of or shareholders of private clubs.</p>	<p>Vlasnici ili akcionari u privatnim klubovima ne mogu biti vlasnici sportskih kladionica.</p>
<b>Neni 20</b>	<b>Article 20</b>	<b>Član 20</b>
<p>1. Kapitali themelor i klubeve private të organizuara si korporata, nuk mund të jetë më i vogël se 150,000 € (njëqind e pesëdhjetë mijë euro).</p>	<p>1. Constitutive capital of private clubs organized as corporations can not be less than €150,000 (one hundred and fifty thousand Euros).</p>	<p>1. Osnovni kapital privatnih klubova Organizovanih kao korporacije, ne može biti manji od 150,000 € (stopedeset hiljada evra).</p>



<p>2. Kapitali nga paragrafi i mësipërm duhet të jetë në të holla të gatshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b></p> <p>1. Klubet private mund të kenë statusin e:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Biznesit Individual;</li><li>1.2. Shoqërisë Kolektive;</li><li>1.3. Shoqërisë Komandite;</li><li>1.4. Shoqërisë Aksionare, dhe</li><li>1.5. Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.</li></ul>	<p>2. Capital from the paragraph above should be in cash.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b></p> <p>1. Private clubs may have the status of:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Individual Business;</li><li>1.2. Collective Company;</li><li>1.3. Commandite Company;</li><li>1.4. Joint Stock Company, and</li><li>1.5. Limited Liability Company.</li></ul>	<p>2. Kapital iz gore navedeno stava treba iznositi u gotovini.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b></p> <p>1. Privatni klubovi mogu imati status:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>1.1. Individualnog poslovanja;</li><li>1.2. Kolektivnog društva;</li><li>1.3. Komaditno društvo;</li><li>1.4. Akcionarsko društvo; i</li><li>1.5. Društvo ograničenih odgovornosti.</li></ul>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b></p> <p>Klubet private të sportit duhet të regjistrohen dhe funksionojnë në përputhje me ligjet që rregullojnë funksionimin e shoqërive tregtare.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b></p> <p>Private sports clubs should be registered and operate in accordance with the laws governing the operation of business companies.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b></p> <p>Privatni sportski klubovi trebaju biti registrovani i funkcionisati u skladu sa zakonima koji regulišu funkcionisanje trgovinskih društva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b></p> <p>Klubet private të sportit, duhet t'i nënshtrohen sistemit të licencimit të cilin e përcakton Federata e sportit përkatës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b></p> <p>Private sport clubs should be subject to the licensing system which is determined by the respective sports Federation.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b></p> <p>Privatni sportski klubovi trebaju podleći sistemu za licenciranje koji određuje odgovarajuća sportska federacija.</p>



<b>Neni 24</b>	<b>Article 24</b>	<b>Član 24</b>
<p>Klubet private të sportit nuk mund të organizojnë sistemin e garave në të cilin do të bëjnë pjesë vetëm klubet private, pa lejen paraprake të Federatës së sportit përkatës.</p> <p style="text-align: center;"><b>PUSHIMI I PUNËS SË KLUBIT PRIVAT TË SPORTIT</b></p>	<p>Private sport clubs can not organize competitions system where only private clubs would participate, without prior permission of the respective sport Federation.</p> <p style="text-align: center;"><b>TERMINATION OF WORK OF PRIVATE SPORTS CLUB</b></p>	<p>Pre dobijanja prethodne dozvole odgovarajuće sportske federacije, privatni sportski klubovi ne mogu organizovati sistem takmičenja gde će učestvovati samo privatni klubovi.</p> <p style="text-align: center;"><b>PREKID RADA PRIVATNOG SPORTSKOG KLUBA</b></p>
<b>Neni 25</b>	<b>Article 25</b>	<b>Član 25</b>
<p>1. Klubi Privat i sportit pushon të ekzistojë:</p> <p>1.1. Me vendimin e themeluesit apo anëtarëve të tij;</p> <p>1.2. Në qoftëse pushon së ekzistuari subjekti juridik i cili është themelues i klubit privat të sportit;</p> <p>1.3. Në qoftëse nuk merret me Aktivitetet për të cilat është themeluar në kohëzgjatje për më shumë se një vit;</p> <p>1.4. Në rastet tjera të parashikuara me ligj.</p>	<p>1. Private sports club ceases to exist:</p> <p>1.1. Upon decision from the founders and its members;</p> <p>1.2. If the legal entity which founded the private sports club ceases to exist;</p> <p>1.3. If it does not deal with the activities for which it was established in duration for more than a year;</p> <p>1.4. In other cases stipulated by law.</p>	<p>1. Privatni sportski klub prestaje da postoji:</p> <p>1.1. Odlukom osnivača ili njegovih članova;</p> <p>1.2. Ako prestane da postoji pravni subjekat koji je i osnivač privatnog sportskog kluba;</p> <p>1.3. Ako se ne preduzimaju aktivnosti za koje je isti osnovan u trajanju više od godinu dana;</p> <p>1.4. U sotalim slučajevima predviđenih zakonom.</p>



Neni 26	Article 26	Član 26
<p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit.</p> <p style="text-align: right;">Kujtim SHALA Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit</p> <p style="text-align: right;">Prishtinë, Data : <u>16 / 03 / 2015</u></p>	<p>This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after it is signed by the Minister of Culture, Youth and Sport.</p> <p style="text-align: right;">Kujtim SHALA Minister of Culture, Youth and Sports</p> <p style="text-align: right;">Prishtina, Date: <u>16 / 03 / 2015</u></p>	<p>Ovo administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja istog od strane Ministra Kulture, Omladine i Sporta.</p> <p style="text-align: right;">Kujtim SHALA Ministar Kulture, Omladine i Sporta</p> <p style="text-align: right;">Pristina, Datum: <u>16 / 03 / 2015</u></p>